



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Datë: 08.05.2024

PROCESVERBAL

**Konsultim publik për Draft Planin e Veprimit Kundër Braktisjes dhe
Mosregjistrimit të Shkollës 2024-2026
I mbajtur më 03.05.2024 (e premte)
VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash**

Konsultimi publik elektronik dhe me shkrim për Draft Planin e Veprimit Kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-2026 ka zgjatur një muaj, nga data 03.04.2024 deri më 03.05.2024. Publikimi i njoftimit për konsultim publik është bërë më datën 02.04.2024, në platformat zyrtare të Komunës.

Njoftimi në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/04/Njoftim-per-diskutim-publik-Plani-kunder-braktisjes-se-shkolles.pdf>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/04/NJOFTIM-PER-DISKUTIM-PUBLIK-Boshnjakisht-Draft-Plani-i-Vepimit-Kunder-Braktisjes-se-Shkolles.pdf>

Njoftimi në Facebook-un zyrtar:

Shqip dhe Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/9xLUviii72YBqvMK/>

Draft Plani i publikuar në rubrikën për konsultime publike:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/04/Draft-Plani-kunder-braktisjes-se-shkolles.docx>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/04/1b.-Opstinski-akcioni-plan-protiv-napustanja-i-neupisivanja-skole-2024-2026.docx>

Diskutimi publik është mbajtur më 03.05.2024, e premte, dhe ka filluar në ora 10:25.

Në këtë diskutim publik kanë qenë prezentë **22 pjesëmarrës, prej tyre 19 meshkuj dhe 3 femra.**

Hapjen e takimit e ka bërë drejtori i DKA-së, Zeni Krasniqi, i cili i ka përshëndetur të pranishmit dhe ka kërkuar që t'i japin vërejtjet, propozimet dhe sugjerimet e tyre në lidhje me përmbajtjen e Draft Planit. Prezantimin e Draft Planit e ka bërë zyrtarja nga DKA-ja, Kaltrina Krasniqi.

Kaltrina Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë dhe ju faleminderit për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim! Ky Plan përfshin një periudhë prej tri viteve, nga vitit 2024 deri në vitin 2026. Nuk e di sa e keni lexuar Planin, kemi planifikuar që ta prezantojmë edhe përmes projektorit, por përderisa nuk kemi projektor, atëherë nuk e di sa e keni përpara Planin e Veprimit që të mund të na përcillni se çka do të flasim. Në përmbajtjen e tij ky Plan ka hyrjen, kontekstin, qëllimin e veprimit dhe objektivat. Tek hyrja është paraqitur një përmbledhje e përgjithshme e arsimit cilësor dhe rolit që ka shteti për masat e nevojshme për sigurimin e këtij arsimit cilësor. Gjithashtu, është paraqitur një përmbledhje e faktorëve që ndikojnë tek braktisja e shkollës nga nxënësit. Për gjitha problemet me të cilat ballafaqohemi, është e nevojshme që të krijohet një hallkë e bashkëpunimit mes komunave, MASHTI-t dhe shtetit, në mënyrë që të rregullohen këto çështje të ndryshme me të cilat përballen nxënësit tanë. Qëllimi kryesor i gjithë këtij Plani të Veprimit është që të sigurohet një arsim cilësor për nxënësit, që do të sigurojë të drejta të barabarta.

Te pjesa e kontekstit, siç e keni parë, është e paraqitur një përmbledhje e përgjithshme statistikore e Komunës së Dragashit, duke përfshirë numrin e banorëve, aspekti gjeografik. Pastaj e kemi të paraqitur edhe një përmbledhje për shkollat në Komunën tonë, sa shkolla kemi, sa objekte etj. Pastaj, kemi numrin e nxënësve të cilët deri më tani e kanë braktisur shkollën, që janë deri 9 nxënës, pesë nga Shkolla “Fetah Sylejmani” dhe katër janë nga Shkolla “Ruzhdi Berisha”. Gjithsej 41 nxënës janë pa prindër, ose pa njërin prind. 13 nxënës deri më tani janë verifikuar se janë me aftësi të kufizuara, në bazë të raportimeve të sakta që i kemi prej drejtorëve, ndërsa 12 nxënës me vështirësi në të nxënë; 22

nxënës me mungesa të shumta dhe në rrezik për braktisje janë dikur rreth 4 nxënës. Në kontekst po ashtu janë paraqitur edhe disa rekomandime që ne i kemi parë të arsyeshme për me e luftue braktisjen e shkollës. Njëri prej tyre është angazhimi i dy psikologëve, sepse për momentin shkollat tona nuk kanë psikolog. Pastaj, kërkesat janë rritur edhe për mësim joformal. Orientimi në karrierë është ndër kërkesat kryesore shumë të rëndësishme. Për momentin ne nuk kemi një të punësuar në shkollat tona që merret me orientimin në karrierë të nxënësve. Pastaj, kemi paraparë që të krijohet edhe një plan zhvillimor në shkolla, që theks të veçantë do ta ketë bashkëpunimin prindër-shkollë-nxënës, për orientimin profesional të nxënësve. Një rekomandim tjetër është krijimi i një pyetësoi për orientim në karrierë, për t'i identifikuar të gjitha preferencat e nxënësve.

Në kuadër të këtij Plani kemi edhe qëllimin. Siç thashë edhe më herët, gjithë qëllimi i këtij Plani është që të krijohet një arsim cilësor për të gjithë në nivel të Kosovës, si dhe të krijohen të drejta të barabarta për disa nxënës që nuk i kanë disatribute sikur nxënësit e tjerë dhe të gjithë të jenë përfitues të arsimit. Në këtë Plan të Veprimit kemi të paraqitur të gjitha objektivat, ku secila nga to i kanë aktivitetet e veta, pastaj i kanë treguesit duhet të jenë pjesë e aktivitetit, afatin kohor, institucionet që do të jenë përgjegjëse për realizimin e aktivitetit, institucionet që do të jenë mbështetëse dhe buxheti për secilin nga këto aktivitete. Në disa aktivitete nuk janë paraparë kosto, por në disa të tjera kemi paraparë një kosto sa ne kemi menduar se është e nevojshme për me u realizue ai aktivitet. Janë dy objektiva të përgjithshme: Objektiva e parë është parandalimi dhe identifikimi i hershëm i nxënësve që janë në rrezik të braktisjes së shkollës dhe ofrimi i këshillimit, mbështetjes dhe motivimit për ata nxënës. Objektiva e dytë është ulja e përqindjes së braktisjes së shkollës, duke krijuar një tranzicion të lehtë nga shkolla e mesme e lartë në shkollën e mesme të ulët, përmes mundësive të zhvillimit të karrierës që përputhen me aftësitë dhe interesat e nxënësve. Buxheti i paraparë për të gjithë këtë Plan të Veprimit, për tri vite është 69,390 euro. Me rishikimin dhe sugjerimin tuaj, kjo mund të ndryshojë.

Të gjitha aktivitetet e parapara për realizimin e këtij Plani i keni të paraqitura në vijim. Ky ishte një përshkrim i përgjithshëm i këtij draft-dokumenti. Tash mirëpresim idetë dhe propozimet e juaja. Në rast se dikush dëshiron të marrë fjalën, urdhëroni!

Eleze Elezi, pedagog i Shkollës së mesme në Dragash: Fillimisht ju përsërisht ju përsërisht juve, si ekip komunal për hartimin e këtij Plani kundër braktisjes së shkollës. Shkolla e mesme, edhe pse nuk është shkollë obligative, në shkollën e mesme “Ruzhdi Berisha” funksionon ekipi. Sipas të dhënave që kemi, kemi disa nxënës, një katër nxënës që kanë braktis shkollën. Jemi mundue disa herë me kontaktue edhe me prindërit, mirëpo është e pamundur – po e theksoj këtë, për arsye se një kosto që e kishit paraqit në atë Planin e juaj, kosto shumë e vogël. Nuk mundet me qenë, për shembull, kostoja e shkollës fillore me të shkollës së mesme, për shkak të reliefit. Unë kam qenë vetë i detyruar – bashkë

me një koleg - me shkue në Restelicë dy herë. Një herë s'kemi mujt me e kontaktue asnjë prind, kështu që na kanë thënë që duhet me ardhë në mbrëmje, derisa të kthehen ata prindërit në mbrëmje te shpia, me kontaktue me ta. Domethënë, kjo kosto për shkollën e mesme po më doket si pak.

Alltane Tershnjaku, zyrtare në DKA: Funkcionalizimin e ekipit me bazë në shkolla, veç janë funksionalizue edhe e kemi pa kosto.

Eleze Elezi, pedagog i Shkollës së mesme në Dragash: Po mu po më duket se nuk është shumë e drejtë, se kur e kemi parasysh shkollën fillore, në bazë të terrenit që ka shkolla, shumë afër edhe nuk ka nevojë kosto, kurse për shkollën e mesme, mendoj se aty duhet me pas një kosto, sado që të jetë simbolike.

Alltane Tershnjaku, zyrtare në DKA: A keni ndonjë vlerë?

Eleze Elezi, pedagog i Shkollës së mesme në Dragash: Jo, nuk kam unë vlerë, po me ju me e parapa si ekip, që aty duhet me pas një vlerë. Mandej, ne si ekip në nivel të shkollës kemi pas probleme një grup të nxënësve, që në atë zhargonin pedagogjik e quajmë "braktisje e heshtur". Kemi kërkuar nga drejtori i DKA-së që këta nxënës, sipas legjislaturës në fuqi, nëse i tejkalon mbi 35 mungesa duhet të jepet dënim, në mënyrë që të përmirësohen ata. Të shkojnë në shkollë tjetër. Pasi këtu nuk kemi gjimnaz tjetër, duhet me shkue në Prizren ose në komunat tjera. Nuk kemi gjet mirëkuptim. Kemi nxënës që kanë arrit 100 mungesa. Një problem i theksuar ka qenë vitin e kaluar. Kemi pas nxënës që kanë përsërit. DKA-ja ka formue një Komision dhe dy nxënës prej tyre i kanë kalue. Ata nxënës për tanë vitin i kemi pas komandantë. Në njëfarë mënyre, kemi pas probleme serioze, edhe kemi edhe sot e kësaj dite. Ata nuk përfillin kujdestar, nuk përfillin profesora në shkollën e mesme. Sepse ju ua keni vu edhe çinat atyre. Prandaj, unë ju kisha sugjeruar që në të ardhmen me pas shumë kujdes. Bile-bile, sipas ligjit, veprimit të DKA-së, nëse kishte bo ndonjë ankesë shkolla, unë po ju them shumë sinqerisht që dikush kishte me shkue në përgjegjësi, për veprimin e juaj që keni bo. Nuk është marrë parasysh profesori i lëndës.

Alltane Tershnjaku, zyrtare në DKA: DKA-ja ka vazhdue procedurat në bazë të udhëzimeve administrative edhe legjislationit në fuqi. Po më vjen shumë keq që s'paska arrit ftesa as te mësimdhënësit, te drejtori i shkollës, as te ata që kanë qenë përgjegjës, kujdestarë të klasës, gjë që Komisioni është formue dhe ka kërkuar testet që janë vlerësue fëmijët në fjalë. Për gjithë atë periudhë që kanë mbet ata, me çfarë testesh dhe me çfarë planprogrami. Drejtorja e shkollës suaj nuk ka çue as test, asnjë gjë, edhe vetë Komisioni është obligue me gjet pyetje lidhur me atë planprogram edhe me iu nënshtruar testit.

Eleze Elezi, pedagog i Shkollës së mesme në Dragash: Pa prezencën e profesorit?!

Alltane Tershnjaku, zyrtare në DKA: Sot jemi thirrë ne për një Plan të Veprimit Kundër Braktisjes. Këto gjëra ju mundeni me i shkruar edhe me iu drejtuar DKA-së, edhe instancave më të larta.

Eleze Elezi, pedagog i Shkollës së mesme në Dragash: Sipas bisedave me profesorët, ata mu më kanë thënë drejtpërdrejt se nuk kemi pas ftesë.

Alltane Tershnjaku, zyrtare në DKA: DKA-ja shkon vetëm me shkrim, pedagog, asnjë me të thonme.

Eleze Elezi, pedagog i Shkollës së mesme në Dragash: Ne të gjithë jemi avokatë të nxënësve, duhet t'i mbrojmë të drejtat e tyre, por jo edhe të tejkalohen të drejtat e tyre.

Alltane Tershnjaku, zyrtare në DKA: Edhe ne jemi për mbrojtje, edhe kemi pas ekip që kanë qenë në shkollë të juaj, janë konsultuar me testet që i kanë lënë 1-sha. Testi kanë qenë jashtë normave për vlerësim. As pikë finale, as pyetje, as të formuara me kompjuter. Ka qenë një test që me e pa dikush, tmerr. Kështu që, unë këtë bisedë unë po due me e mbaruar këtu, edhe me vazhduar me këtë Plan të Veprimit. E, ato që janë lidhur me këtë ankesë të juajën, shkruar edhe drejtonë në DKA.

Eleze Elezi, pedagog i Shkollës së mesme në Dragash: Faleminderit, mirëpo këto lidhen, nëse nuk lidhen drejtpërdrejt, indirekt këto lidhen me braktisjen. Se pikërisht ata nxënës që janë kthyer në atë mënyrë, kanë më së shumti mungesa, edhe ata kanë qenë rrezik prej fillimit për braktisje, edhe janë. Rregullisht ne e kemi bashkëpunimin mes shkollës dhe DKA-së, se i çojmë të dhënat sa herë që i kërkon.

Samir Shabani nga Këshilli i Prindërve: Unë e mbështes propozimin e profesorit. Ndoshta kish me qenë mirë që të jetë një kosto të pika 1.1.2. Nëse te kjo e para është 300, atëherë ndoshta me qenë 150 euro, sa për stimulim. Përndryshe, unë e mbështes këtë Plan.

Alltane Tershnjaku, zyrtare në DKA: Te formimi i ekipeve në kuadër të shkollës ne i kemi lënë pa kosto, se ato brenda shkollës formohen edhe s'kanë nevojë. Por është si propozim, edhe e marrim parasysh. Nëse nuk ka edhe diçka tjetër, atëherë e mbyllim këtë diskutim publik! Ju falënderojmë për pjesëmarrje!

Diskutimi publik ka përfunduar në ora 11:05!

Linqet e lajmeve për mbajtjen e diskutimit publik, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:

Në uebfaqe:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/news/u-mbajt-konsultim-publik-per-draft-planin-e-veprimit-kunder-braktisjes-dhe-mosregjistrimit-te-shkolles-2024-2026/>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/sr/news/danas-je-odrzana-javna-rasprava-o-nacrtu-akcionog-plana-protiv-napustanja-i-neupisa-u-skolu-2024-2026/>

Në Facebook:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/e5vLsw3uFPuK57cs/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/mtY8Xvj7QnF7fRp/>

SHTOJCË: *Lista e pjesëmarrësve në diskutim publik dhe fotografitë*



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Data/Datum: 03.05.2024

Vendi/Mesto: Salla e Kuvendit Komunal -- Dragash/ Sala Skupštine Opštine - Dragaš

LISTA E PJESËMARRËSVE NË DISKUTIMIN PUBLIK PËR
PLANIN E VEPRIMIT KUNDËR ERAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT
TË SHKOLLËS 2024-2026

LISTA UÇESNIKA NA JAVNOJ RASPRAVI ZA AKCIONOG PLANA
PROTIV NAPUŠTANJA I NEUPISA ŠKOLE 2024-2026

Nr. Br.	Emri dhe Mbiemri Ime i Prezime	Vendbanimi Prebivalište	Etnia Etnička pripadnost	M M	F Ž	Nënshkrimi Potpis
1	Altanë Bërdimaku	Plavi	Shqiptare		X	<i>[Signature]</i>
2	Brendi Beqiri	Duge	Shqiptare	X		<i>[Signature]</i>
3	Kaburim Krasniq	Brane	Shqiptare		X	<i>[Signature]</i>
4	Flurim Gemyri	Pllupin	Shqiptare	X		<i>[Signature]</i>
5	SADIK SHABAN	Shenje	Shqiptare	X		<i>[Signature]</i>
6	FADIL BASHI	BELOBRAN	SHQIPTAR	X		<i>[Signature]</i>
7	Behar Guri	Kosovë	SHQIPTAR	✓		<i>[Signature]</i>
8	Naser Myrtezani	Zaplluxhe	Shqiptar	X		<i>[Signature]</i>
9	Elza Plezi	Pl.	Shqiptar	✓		<i>[Signature]</i>
10	Phopert Bojda	Porod	Bošnjak	X		<i>[Signature]</i>
11	Bajram Hotka	Reatlica	Tijerke	✓		<i>[Signature]</i>
12	Selmir Karagja	Reatlica	Bosnjak	✓		<i>[Signature]</i>
13	Aben Emir	Zguri	sa. Shqiptar	✓		<i>[Signature]</i>
14	Canan Suanlorraku	Broci	Bosnjak	✓		<i>[Signature]</i>
15	Agon Borçalu	Bellebrad	Shqiptar	✓		<i>[Signature]</i>
16	Olga Krasniq	Buce	Shqiptar	✓		<i>[Signature]</i>
17	Fati Koloni	Kerani	Shqiptar	✓		<i>[Signature]</i>
18	Kapellon Fetahu	Kuk	Shqiptar	✓		<i>[Signature]</i>
19	Anjeta Shehaj	Bienc	Shqiptare	✓	✓	<i>[Signature]</i>
20	Lejla Jakubi	Blac	Shqiptare	✓		<i>[Signature]</i>
21	Veton Halili	Zaplluxhe	Shqiptar	✓		<i>[Signature]</i>
22	Dremi Myrtezani	Zaplluxhe	Shqiptar	✓		<i>[Signature]</i>
23						
24						

